



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr 128, datë 28 /10/2021

**‘PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË DHËNIES ME QIRA, TË TRUALLIT ME
SIPËRFAQE 205 M2, PJESË E PASURISË NR.2/353 ZK 8563, PËR QËLLIME
BIZNESI’**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria Juridike bazuar në nenin 54 gërma e/1 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe bazuar në VKM nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.13 datë 26.04.2018 “Për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.54 date 05.02.2014”, si dhe në VKM Nr.1532 datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Korçë të Qarkut të Korçës” dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fillimin e procedurave për dhënien me qira të truallit 205 m2, pjesë e pasurisë nr.2/353 ZK 8563 me vendndodhje në Rruga Partizani, Lagjia 14, Korçë për një afat 1 (një) vjeçar, me tarifën minimale 100 lekë/m2 në muaj, sipas genplanit bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Erjon Nexhipi

